



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 19680 Prot

Vlorë, më 05.12 2024

PROCESVERBAL

KONSULTIM ME PUBLIKUN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT
KULLOSOR SHASHICË GUMENICË NË PRONËSI TË BASHKISË VLORË PËR
VEPRIMTARI FOTOVOLTAIKE

Data: 03.12.2024 ora 17.00

Vendi: KANINË

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë.

Marrin pjesë:

Ermal Dredha-Kryetar i Bashkisë Vlorë, Elpiniqi Mërkuri- Kryetare e Këshillit Bashkiak, Dorian Demiraj- Drejtor, Drejtoria Juridike, banorë të zonës, kryeplaku i fshatit Kaninë, përfaqësues nga komuniteti dhe media.

Takimin e hapi z.Ermal Dredha: Përshëndetje dhe ju falenderoj që keni ardhur kaq shumë sot.

E keni informacionin, por jam këtu për të dhënë informacion të saktë. Ky takim organizohet për të diskutuar atë që është bërë disa ditë më para në mbledhje, për menaxhimin e 800 ha që duam ti vendosim në një fazë studimi, që të mirëkuptohemi për këtë, bëhet fjalë për strategjinë që ka qeveria shqiptare për sa i përket pjesës së energjisë së rinovueshme, në gjithë territorin e Shqipërisë. Është parë që Shqipëria është vend potencial që mund ta përkthej këtë në të ardhura Brenda vendit dhe në rajon për energjinë e rinovueshme, jeshile. Që përpara 2 vitesh, para se të vija unë në bashki ka patur disa kërkesa, nga kompani të mëdha për energjinë diellore në zonën e Vlorës. Duke marr shkas nga politikat qendrore për sa i përket shtimit të investimit në këtë sektor sepse e shikojnë që ka potencial, dhe si detyrim ligjor që ka vetë bashkia, edhe nga shprehja e interesit që ka një kompani e cila mund ta shikoj me interes investimin, jemi të detyruar përpara se ta kalojmë në këshillin bashkiak të organizojmë një dëgjuesë, që do të thotë komuniteti të jetë i

informuar për të gjithë procesin që ndiqet. Janë 800 ha që janë në moment studimi, jo sikurse jeni informuar gabim, është aset publik, është në certifikatë si pronë e bashkisë së Vlorës. Kam dëgjuar zëra që ka pretendime që mund të ketë edhe pronar, që janë në proces për ta parë, nuk i anashkalojmë ata që e quajnë veten pronar dhe nëse nesër certifikohen nëpërmjet gjykatës apo institucionet qendrore, patjetër që mund të jenë pjesë e këtij procesi dhe nuk ka asgjë të keqe këtu. Në këtë moment që flasim, nuk është bërë asnjë kontratë nga bashkia, por ne e kemi detyrim ligjor që për një shprehje interesi të organizojmë dëgjuesë. Ky është një studim për zonën, është tokë shtet, tokë e pashfrytëzueshme, e cila nuk përdoret. Këto janë 800 ha për studim, si asset public, jo e gjitha do kaloj në shfrytëzim. Është faza e fillimit që ne duhet të reagojmë, ju garantoj se ka mbi 2 vjet që diskutohet kjo gjë, s'dua të akuzoj njëri, si kryetar dua të ndjek hallkat ligjore sic duhet pa anashkaluar asnjë qytetar. Nuk ka segment të errët që të anashkalojmë njerëzit. Në momentin që bëhet ky studim dhe dilet në përfundim, si dhe kush janë kompanitë që aplikojnë apo nga institucionet qendrore si ministria e infrastrukturës, energjitikës e me radhë mund të lejohet që të bëhet një investim i tillë, është hallkë tjetër. Sot jemi për studimin e zonës që është 800 ha ka potencial për një investim të tillë, pra për energjinë e rinovueshme, diellore. Marr shkas edhe nga investime të tjera të ngjashme që janë bërë edhe në territorin e Shqipërisë, Fier, veri, Librazhd, psh Saranda, para 2 muajsh u tërhoq nga procedura sepse prona nuk kishte statusin sic e ka bashkia e Vlorës, pra pronë që posedohet nga bashkia. Momenti që vërtetoni se jeni pronar dhe nëse miratohet, toka juaj është pjesë e investimit atëherë patjetër mund të bëhet pjesë e procesit. Ka hapësira edhe për kullota, ata që i kanë me qera 6 muaj mund të vazhdojnë prapë, nuk pengohen. Është studim ekonomik për zonën. Ne jemi të detyruar që kur ka shprehje interesi për investime të energjisë të ndjekim procesin. Jam këtu për tju përgjigjur, mos u ndjeni të sabotuar. Nëse shikojmë sa përfiton bashkia si institucion nga kullota dhe më vonë. Nëse marr 176 lek të reja për ha imagjinoni sa do jetë për shfrytëzim. Në 800 ha nuk do jetë i gjithë investim. Është transmetuar keq. Kjo është faza e parë. S'ka kontratë për momentin. Kam revokuar shumë kontrata fiktive të mëparshme sepse s'kanë ndjekur rrugën ligjore, që të gjithë të jenë të përfshirë në këtë process, që ta keni të qartë këtë. Tani vazhdoni ju.

Banor: Ku do bëhet? Janë 800 ha dhe janë të ndara. Unë dua të di sa humbas? Ku do ti çoj kullotat?

Z. Ermal Dredha: 800 ha janë për studim. Aty kur të bëhet mund të bëhen 100 apo 200. Atje do shkosh prapë. Ligji që është miratuar për energjinë diellore, edhe po u vendosën, e zëmë se u vendosën, sepse nuk është bërë gjë akoma, ato nuk rrethohen, prapë aty do i çosh dhentë se janë 2 m të lartë. Edhe kur të bëhet prapë ankandi nëse do investohet, nuk do investohet e gjitha në 800 ha. Gjysma e hapësirës do jetë e pashfrytëzuar. Ky investim do prodhojë ekonomi edhe për ju, vende punësimi.

Banor: 7000 krerë të miat ku ti çoj?

Z. Ermal Dredha: Sa ha të duhen për ti kullotur?

Banor: Në mbledhjen e fundit të këshillit bashkiak, keni kërkuar këshillit të lidhen kontrata me subjektin. Është kthyer nga këshilltari për dëgjuesë, Gjergj Nikaj. Kur duhet të ishte dëgjuesja e para, komisioni i bujqësisë i dyti dhe pastaj në këshill. Nëse jua jep këshilli gjyshërit tanë kanë

luftuar do luftojmë edhe ne. Kontrata lidhet për 800 ha, 100 ha ja jepni subjektit. Studimi është i qeverisë, le ta bëjë, me autorizimin e qeverisë i jepni privatit gjithë Kaninën.

Banor: Përse bëhet kjo punë? Pse s'u bë në Karaburun, Dukat? Apo i përzunë dhe erdhën këtu?

Z. Ermal Dredha: Po të ishte i vëmendshëm, do e kishte dëgjuar rrugën ligjore që duhej ndjekur. Këtu ka patur mungesë ligjshmërie dhe i rregulluam. Prandaj po e bëjmë dëgjesën. Është inisiativë sipas hallkave që ndiqen. Këto investime kanë filluar më para në qytete të tjera. Shprehjet e interesit do shikohen sipas hapave ligjore.

Banor: Mos këmbëngulni si kryetar bashkie. Sot që flasim jemi pa ujë e ju na merrni tokën për energji diellore.

Banor: Komuniteti nuk pranon. Kemi sakrifikuar, kemi mbijetuar nuk ikëm si të tjerët. Pak kanë ngelur nga ne, jemi mbledhur sot këtu të gjithë sa jemi. Ju na keqpëdorni.

Banor: Ju vë në dijeni, presim shumë. Kam 50 krerë. Jemi para faktit. Tokat kanë pronar. Ti si kryetar ndërhy që të bëhet marrveshje me pronarin e tokës jo me ty.

Banor: Jemi në pikën kush ka lek do përfitoj. 5 milion lekë kam bagëti që ushqej dhe shkolloj fëmijët. Të respektojmë si vëllain tonë. Shashica është e Kaninës, s'ka vend për dëgjesë. Vin ai që ka lekë.

Z. Ermal Dredha: E kam për detyrë të bëj dëgjesë për transparencë.

Banor: Komisioni ti kthejë te pronarët. Ku ka vend bosh ndiko. Aty ku ka pretendime nga pronarë të ndalohej.

Banor: Kush e ka të drejtën e privatësisë së tokës?

Banor: S'na sjell asgjë të mirë. Mos na pyesni kot.

Banor: Të kujt janë parcelat? Toka është e jona, kemi dhënë jetën. Jo ta merrni me 1 euro.

Ermal Dredha: Nuk është 1 euro.

Banor: Ne s'kemi ujë. E marrim ujin në Vlorë me racion, ti na merr tokat.

Banor: Interesat e shtetit janë të mëdha. Për detin që u shit morët shumë lek.

Banor: Ke bërë kontratë me ne? Nga 6 mujore bëje 10 vjeçare.

Banor: Ku do ti coj 7 mijë krerë bagëti.

Gjergj Nikaj-Këshilltar: Dëgjojeni njerëzit. Duhet t'ju nxjerrin jashtë. I tregoni realitetin. Ngrijeni zërin, bëhuni burra, mos shkëlmi parimet.

Banor: Pse nuk ngrihesh ti?

Banor: Këta njerëz që kanë marrë tokën me qera për 30 vjet ku do shkojnë? Duhet një plan studimi për këta njerëz.

Banor: Nuk lejohet fare.

Banor: Nuk bëhet me gjithë respektin. Ajde shiko ku jetojmë. Ku ti çojmë? Llogaritë e bashkisë ke bërë? Po tonat? Shyqyr që u mblodhëm se kanë ikur të gjithë. Mos na kërkoni më.

Banor: Është e padiskutueshme. Po e doni, do na bëni fli në rrugë. Nuk ikim.

Banor: Problem. Të ra fati si kryetar bashkie bashkie. O kaninjot, o vëllezër deri këtu arrita.

Z. Ermal Dredha: Po diskutojmë një shprehje interesi, nuk po vendosim. E kam për detyrë të ndjek procesin.

Banor: Ky nuk është studim, është keqinformim. Doni leje nga këshilli për të vendosur.

Banor: Me gjithë respektin të themi STOP. Boll probleme kemi, ca i dini, ca jo. I pari problem është Landfilli, zyrat nuk hapen, s'kemi asnjë përgjigje. Kompensim s'kemi marrë, jemi 10 veta. Së dyti ujrart e zeza. Stop, s'ka shance për këtë.

Banor: Sa përfiton bashkia? Sa ne?

Banor: Kontratat të bëhen me ne, jo me ty. Të votohet kush është dakort. Të kishe sjellë një hartë ku do e marrësh tokën për panelet.

Banor: Shtet është? Proces regjistrimi sipas ligjit, të na përgjigjet Agjensia e kompensimit.

Z. Ermal Dredha: Po të ishit pronar?

Banor: Jam unë pronar!

Banor: Nuk bëhet!

Banor: Nuk bëhet o kryetar, mos e thuaj më.

Banor: Përfitojnë ata që kanë lekë dhe që investojnë, jo ne.

Banor: Nxjerr VKM si Palasa, bën ça do.

Geron Gunbardhi-Këshilltar i KB: Je si në shtëpinë tënde. Të kanë votuar unanimisht, mos ju mbush mëndjen që ju leverdis. Po bën konsultim? Hidhe në votë, doni apo jo. Përmbli dhe me 2 fjali, jeni dakort apo jo? Bëj dicka të bukur për Kaninën, një fshat turistik, jo panele dhe sëmundje.

Banor: S'jemi dakort asnjëri!

Banor/Kryeplak: Kam qënë me të gjithë banorët në takim. Nuk janë dakort, stan më stan dhe derë më derë i kam pyetur.

Banor: Ndhimmo të marrim pronat e tyre kta njerëz. Je pjesë e jona. Të mbahesh mend.

Z. Ermal Dredha: Po ju informoj sipas ligjit. Ju thash çfarë po ndodh. Këtë kam detyrim. Të shikoj shprehjen e interesit duke ndjekur procesin. Nuk është bërë kontratë. Çështja e pronave

është komplekse. Çfarë keni me letra janë tuajat, ti gëzoni. Po flas për tokën shtet sipas kadastrës. Është tokë shtet prandaj vendosim.

Banor: E kam tokën me AMTP.

Konceptoi: Albana Naçi

Koordinatore për Njoftimin dhe Konsultimin Publik